

SHOQERIA "KALIMERA" SH.P.K  
Vanister  
GJIROKASTER

## V E N D I M N R.12

### I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "KALIMERA" SH.P.K.

Asambleja e Jashtezakonshme te Shoqerise "Kalimera" Sh.p.k. e mbledhur sot me daten 18.12.2005 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga administratoret e saj per miratimin e raportit te ekspertit per zmadhim (shtim) te kapitalit.

### K O N S T A T O I S E:

Me Vendimin e dates 21.06.2005 dhe te dates 28.07.2005 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "Kalimera" Sh.p.k. eshte miratuar kerkesa e ortakeve per zmadhim te kapitalit te shoqerise nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2004, pasi te zbritet shuma e percaktuar per tu shperndare ne forme dividenti sipas raportit qe do te hartohet nga eksperti per vleresimin e kontributeve nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2004.

Ne diskutimin e bere nga ortaket te shoqerise u shprehen per raportin e ekspertes kontabel te autorizuar zj.Leze Abazi, lidhur me shumet e pasqyruara ne raportin e hartuar dhe dokumentacionin baze bashkengjitur ketij raporti per vleresimin te kapitalit qe do te zmadhohet ne formen e kontributeve (fitimet) nga ortaket e shoqerise. Per sa me larte ne mbeshetje te Statutit te Shoqerise dhe neneve 61,63 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e jashtezakonshme e shoqerise,

### V E N D O S I

1.Miratimin per zmadhim te kapitalit prej 2.900.000 leke, pra nga 52.100.000 leke qe ishte te behet prej 55.000.000 leke nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2004 dhe pasi eshte zbritur shuma e percaktuar per tu shperndare ne forme dividenti, sipas raportit te ekspertit kontabel.

2.Kapitali zoterohet nga ortaket:

- Z.Jorgo Papa me pjesemarrje 32%, ose ne vlefte prej 17.600.000 leke,
- Z.Sokrat Kiki me pjesemarrje 28 %, ose ne vlefte prej 15.400.000 leke,
- Znj.Ollga Papa me pjesemarrje 20 %, ose ne vlefte prej 11.000.000 leke,
- Z.Vasil Papa me pjesemarrje 20 %, ose ne vlefte prej 11.000.000 leke.

3.Gjithe dokumentacioni i pregatitur per zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet deri me 31.12.2004 te Shoqerise "Kalimera" Sh.p.k. te depozitohet ne regjistrin tregtar sipas kerkesave te Ligjit "Mbi Shoqerite Tregtare " dhe statutit te shoqerise.

Vendimi u miratua nga ortaket.

### ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE "KALIMERA" SH.P.K.

Jorgo Papa

KALIMERA CO  
VANISTER GJIROKASTER  
TEL. 0980946107808

Sokrat Kiki

KALIMERA CO  
VANISTER GJIROKASTER  
TEL. 0980946107808

Ollga Papa

KALIMERA CO  
VANISTER GJIROKASTER  
TEL. 0980946107808

Vasil Papa

KALIMERA CO  
VANISTER GJIROKASTER  
TEL. 0980946107808